



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM
K.P.P.667/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21/09/2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomik “Arb Security” shpk dhe “Vaso Security” shpk, nga procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-16022-06-01-2017 me objekt: “Shërbimi i ruajtjes fizike të objekteve të Ujësjetës Kanalizime Sh.a Pogradec për 11 muaj”, me fond limit 15,356,460 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 11.08.2017, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetës Kanalizime Sh.a Pogradec.

Ankimues:

“Nazeri 2000” sh.p.k
Rruga “Kavajës” Qendra Condor, Kati II Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Ujësjetës Kanalizime Sh.a Pogradec.
Adresa “Guras” Pogradec.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator i ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 02.06.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-16022-06-01-2017 me objekt: “Shërbimi i ruajtjes fizike të objekteve të Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Pogradec për 11 muaj”, me fond limit 15,356,460 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 11.08.2017, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Sh.a Pogradec.

II.2. Në datën 11.08.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 16.08.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Florian Abedinaj”	Pa dokumentacion dhe pa ofertë	s’kualifikuar
2. “Iral”	Pa dokumentacion dhe pa ofertë	s’kualifikuar
3. “Security Korça”	Pa ofertë	s’kualifikuar
4. “Arb Security”	13.331.183.72 lekë	kualifikuar

5. "Vaso Security"	13.669.920.6	lekë	kualifikuar
6. "Nazeri 2000"	14.014.107	lekë	kualifikuar

II.4. Në datën 16.08.2017 operatori ekonomik "Nazeri 2000" shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, nga ku rezulton se operatori i sipërcituar është kualifikuar në këtë procedurë prokurimi.

II.5. Në datën 21.08.2017 operatori ekonomik ankimues "Nazeri 2000" shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me anë të së cilës kundërshton vendimin e KVO-së, për kualifikimin e operatorëve ekonomik "Arb Security" shpk dhe "Vaso Security" në mënyrë të përmblodhur me argumentet si mëposhtë:

- **Së pari:** Autoriteti dyhet të skualifikojë shoqëritë "Arb Security" shpk dhe "Vaso Security" shpk, pasi nuk plotëson kërkesën 3.3 Kapaciteti teknik për "Autorizim Individual për operatorin ofertues, lëshuar nga AKEP për "Radio Komunikim dhe Alarm" konformë ligjit nr 9918, datë 19.05.2008, ku autroizimi të mbulojë më radio komunikimi dhe radio alarm vëndin e kryerjes së shërbimit, i cili përfshihet në Qarkun e Korcës". **Këto shoqëri nuk kanë paraqitur AKEP qarku Korçë sipas kërkesës së dhënë.**
- **Së dyti:** Autoriteti duhet të skualifikojë shoqërinë "Arb Security" shpk, dhe "Vaso Security" shpk, pasi nuk plotëson kërkesën 3.3 Kapaciteti teknik për "Të ketë jo më pak së 27.45 punonjës shërbimi. **Këto shoqëri nuk e kanë përmblodhur këtë kërkesë pasi nuk kanë paraqitur vërtetimin e lëshuar nga DPQ dhe certifikatat të vlefshme për 27.45 punonjës.**
- **Së treti:** Autoriteti duhet të skualifikojë shoqërinë "Arb Security" shpk dhe "Vaso Security" shpk, pasi nuk plotëson kërkesën 3.3 Kapaciteti teknik për "Të ketë jo më pak se 9 armë gjithsej pra një armë për secilin objekt në ruajtje bazuar në urdhrin nr 155, datë 29.05.2014 të Ministrit të Rendit Publik, "Për pajisjen e shoqërive me armatim", pika 3/a si dhe të shoqëruar me vendimin e dhënies së lejes së armëve ose me anë të dokumentacionit të përcaktuar në ligjin 74/2014 "Për Armët", ose me anë të dokumentacionit konkret nenit 5, 7 dhe 8, si dhe me anë të dokumentacionit konkret për kalim pronësie, të ketë shlyer detyrimet financiare për vitin 2016, "Operatori ekonomik bazuar në nenin 8 pika 2 gërma (a) dhe (b), si dhe nenit 34 të ligjit nr 74/2014 "Për Armët" dhe akteve nënligjore, subjektet e shërbimit privat të sigurisë fizike gëzojnë të drejtën e mbajtjes së armëve të zjarrit "B1" dhe "B4", duhet të disponojë 6 armë "B1" dhe 3 armë "B4". **Këto shoqëri nuk kanë plotësuar kërkesën e dhënë për 9 armë ku duhet të jenë 6 armë "B1" dhe 3 armë "B4".**
- **Së katërti:** Autoriteti duhet të skualifikojë shoqëritë "Arb Security" shpk dhe "Vaso Security" shpk pasi nuk plotëson kërkesën 3.3 Kapaciteti teknik për "Vërtetim të lëshuar nga komuna ose bashkia ku ka aktivitet për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për tri vitet e fundit". **Këto shoqëri nuk plotësojnë kërkesën për shlyerjen e taksave të Bashkisë sipas vendodhjes ku kanë aktivitet për 3 vitet e fundit.**
- **Së pesti:** Autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë shoqëritë "Arb Security" shpk dhe "Vaso Security" shpk, pasi nuk plotëson kërkesën 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar për "Një certifikatë të gjëndjes financiare nga një ose më shumë banka, të marra jo më shumë se 10 ditë nga data e hapjes së ofertave që mbulon 10 % të fondit limit. Nuk kanë paraqitur vërtetim

banke në vlerën dhe afatin e kërkuar në DST. Si dhe nuk plotësojnë kërkesën për vërtetim që kanë shlyer detyrimet e maturuara të energjisë elektrike siç është kërkuar nga AK në dst.

- **Së gjashti:** Autoriteti duhet të skualifikojë shoqëritë “Arb Security” shpk dhe “ Vaso Security” shpk, pasi nuk plotësojnë kërkesën 3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar për “Operatori ekonomik duhet të paraqesë analizën e kostos për një roje duke u mbështetur në ligjin 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, nënit 81 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës”, VKM Nr.399, datë 03.05.2017, “Përcaktimin e pagës minimale”, si dhe Urdhrit nr 157, datë 01.04.2015 të Ministrit të Punëve të Brëndshme. **Këto shoqëri nuk kanë paraqitur analizë kostoje dhe nuk kanë plotësura preventivin sipas tabelës të dhënë në DST tek Shtojca 1.**
- **Së shtati:** Autoriteti duhet skualifikojë shoqëritë “Arb Security” shpk dhe “Vaso Security” shpk, pasi këto shoqëri nuk kanë përmbushur shpenzimet e detyrueshme ligjore për pagë minimale (në bazë të VKM-së Nr. 399), në vlerën 36 000 lekë, shtesa turni dytë dhe i tretë në përputhje me Kodin e Punës, sigurime shoqërore, shëndetsore (në masën 16.7%). **Pra këto shoqëri kanë ofertuar nën koston ligjore të lejuar, duke mos përmbushur kështu të gjitha shpenzimet e detyrueshme ligjore dhe referuar argumentave ligjore të cilat i parashtruan si më sipër.**

Sa më sipër kërkojmë nga Ak skualifikimin e shoqërive *Arb Security” shpk, dhe “Vaso Security” shpk, se nuk kanë përmbushur shpenzimet e detyrueshme ligjore në përputhje me kërkesat e AK dhe nuk kanë përmbushur kërkesat e dhëna në DST.*

II.6. Në datën 23.08.2017, me shkresën Nr. 537/1 prot, operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk, është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.7. Në datën 31.08.2017, pala ankimuese “Nazeri 2000” shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës me Nr. 556/1 prot datë 08.09.2017 protokolluar me tonën me Nr. 1426/2 datë 11.09.2017, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk, për kundërshtimin e kualifikimit të ofertave për shoqëritë: “Arb-Security” shpk, dhe “Vaso-Security” shpk, me arsyetimin “se këto shoqëri nuk plotësojnë kriterin 3.3 Kapaciteti teknik të dokumentave të tenderit,

këto shoqëri nuk kanë paraqitur AKEP qarku Korçë sipas kërkesës së dhënë. Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1 Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar:

- Autorizim Individual për operatorin ofertues, lëshuar nga AKEP për “Radio Komunikim dhe Alarm” konform ligjit nr. 9918 dt 19.05.2008, ku autorizimi të mbulojë me radio komunikim dhe radio alarm vëndin e kryerjes së shërbimit, i cili përfshihet ne Qarkun e Korçës.

III.1.2. Në dokumentat e tenderit tek “Njoftimi i Kontratës”, Seksioni II Objekti i Kontratës, pika 2.4 përcaktohet: “Vëndi i kryerjes së shërbimeve: 1- Stacioni i pompave dhe kaptazhi Tushemisht, 2- Depo Uji Verdovë, 3- Burimet Kabash, 4- Impjanti i Trajtimt të Ujrave të përdorura Guras, 5- Zyrat qëndrore Gurras, 6- Qëndra e Shërbimit Konsumator Pogradec, 7- Zyrat e Pagesës Nr. 1 (Lgji 3) Pogradec, 8- Zyrat e Pagesës Nr. 2 (Lgji 3) Pogradec, 9- Zyrat e Pagesës Buçimas.

III.1.3. Në përmbushje të kriterit të mësipërm operatorët ekonomikë “Arb-Security” shpk, dhe “Vaso-Security” shpk, kanë dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) dokumentacionin si më poshtë:

Bashkimi i operatorëve Arb-Security” shpk & “Ilar” shpk.

- Autorizim Individual për subjektin “**Arb Security**” shpk, me Nr.Al-UI 2021, datë 22.04.2015, “Për caktimin dhe përdorim frekuencash në brezat VHF, UHF. Sisteme Radiokomunikimi, Vendhohja Elbasan, zona ku ofrohet shërbimi “Qarku Elbasan, Cërrik - 15 km”.
- Autorizim Individual për subjektin “**Arb Security**” shpk me Nr.Al-U 2021, datë 22.04.2015, “Për caktimin dhe përdorim frekuencash në brezat VHF, UHF. Sistem Radiokomunikimi, Vendhohja Tiranë dhe zona e mbulimit “Tiranë, Kashar, Dajt, Qafshamë -20 km”.
- Autorizim Individual për subjektin “**Arb Security**” shpk me Nr.Al-U 2021, datë 22.04.2015, “Për caktimin dhe përdorim frekuencash në brezat VHF, UHF. Sistem Radiokomunikimi, Vendhohja Shijak dhe zona e mbulimit (ofrohet shërbimi) “Shijak, Fllakë -15 km”.
- Autorizim Individual për subjektin “**Ilar**” shpk me Nr.Al-U 1460, datë 18.02.2015, “Për caktimin frekuencash në brezat VHF, UHF, SHF dhe HF Sistem Radiokomunikimi, Vendhohja (Zona Gjeografike) “Korçë -10 km dhe Pogradec -10 km”.
- Autorizim Individual për subjektin “**Ilar**” shpk me Nr.Al-U 1460, datë 18.02.2015, “Për caktimin frekuencash në brezat VHF, UHF, SHF dhe HF Sistem Radioalarm, Vendhohja (Zona Gjeografike) “Pogradec -10 km”.
- Autorizim Individual për subjektin “**Ilar**” shpk me Nr.Al-U 1460, datë 18.02.2015, “Për caktimin frekuencash në brezat VHF, UHF, SHF dhe HF Sistem Radiokomunikimi, Vendhohja (Zona Gjeografike) “Tiranë -10 km”.
- Autorizim Individual për subjektin “**Ilar**” shpk me Nr.Al-U 1460, datë 18.02.2015, “Për caktimin frekuencash në brezat VHF, UHF, SHF dhe HF Sistem Radioalarm, Vendhohja (Zona Gjeografike) “Tiranë -10 km”.

Operatori ekonomik “Vaso Security” shpk

- Autorizim Individual për subjektin “**Vaso Security**” shpk, me Nr.Al-U 1413, datë 17.01.2014, “Për caktimin dhe përdorim frekuencash në brezat VHF, UHF. Sisteme Radiokomunikimi,

Vendhohja Ersekë, zona ku ofrohet shërbimi “Rrethet Korçë, Devoll, Pogradec dhe Ersekë -50 km”.

- Autorizim Individual për subjektin “**Vaso Security**” shpk, me Nr.AI-U 1413, datë 17.01.2014, “Për caktimin dhe përdorim frekuencash në brezat VHF, UHF. Sisteme Radioalarmi, Vendhohja Korçë, zona ku ofrohet shërbimi “Korçë -15 km”.

III.1.4. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.5. Në nenin 28 pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose[...].”

III.1.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

III.1.7. Në nenin 44 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se “Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm. Autoriteti kontraktor duhet t’i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të

shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit”.

III.1.8. Në Kreun VIII (“Kushte të përgjithshme për zbatim”), neni 74 (“Bashkimi i operatorëve ekonomikë”), pika 1, 2 dhe 3 të Vendimit Nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se : “1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi... Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, nëse kërkohet, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.” “3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

III.1.9. Sqarojmë se, referuar bazës ligjore si më sipër cituar si edhe kontratës së bashkëpunimit, përmbushja e kriterëve dhe kërkesave të autoritetit kontraktor duhet të bëhet nga secili anëtar i bashkimit në përputhje me përqindjen e punëve të marra përsipër.

III.1.10. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit

III.1.11. Në nenin 66, të Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: "AKEP-i lëshon një autorizim individual për përdorimin e frekuencave, në përputhje me PKRF-në dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave , për caktimin dhe përdorimin e frekuencave sipas neneve 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70 dhe 71 të këtij ligji."

Në këto autorizime, përcaktohet edhe zona e mbulimit (neni 70, pika 1, e Ligjit të lartpërmendur), ku përcaktohet se "Autorizimi individual për përdorimin e frekuencave përmban: a) të dhëna për përfituesin; b)frekuencat e përfituara ; c) vendndodhjen dhe zonën e mbulimit; ç) afatin e vlefshmërisë së autorizimit; d) kushtet, që duhet të përmbushen për shfrytëzimin e frekuencës së caktuar, sipas nenit 71 të këtij ligji".

III.1.13. Bazuar në sa më sipër KPP sqaron se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar

është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me *lex specialis*.

III.1.14. Referuar sa më sipër, Komisioni gjykon se operatorët ekonomik të kualifikuar “Vaso Security” dhe bashkimi i operatorëve ekonomik “Arb Security” shpk & “Ilar” shpk me anë të dokumentacionit të paraqitur nuk dëshmojnë se disponojnë Autorizim Individual për “Radio Komunikim dhe Alarm” të lëshuar nga autoriteti i komunikimeve elektronike dhe postare me zonë mbulimi vëndin e kryerjes së shërbimit të objekteve nën varsi të autoritetit kontraktorë Ujësjiellës Kanalizime Sh.a Pogradec. Konkretisht operatori ekonomik “Vaso Security” shpk ka paraqitur autorizim individual për sisteme Radiokomunikimi për Rrethet Korçë, Devoll, Pogradec dhe Ersekë - me zonë mbulimi 50 km, ndërsa për sistemet e Alarmit ka paraqitur autorizim individual vetëm për Qytetin e Korçës me zonë mbulimi 15 km. K.P.P referuar distancës në kilometra e përcaktuar në autorizimin individual përkatëse për Radioalarm, nuk përfshin në frekuencë distancën reale të qytetit të Pogradecit, qytet në të cilin ndodhen objektet e kryerjes së shërbimit.

Ndërsa përsa i takon bashkimit të operatorëve ekonomik “Arb Security” shpk dhe “Ilar” shpk, rezulton që operatori “Arb Security” shpk ka paraqitur autorizim individual për sisteme Radiokomunikimi për Qarku Elbasan, Cërrik - 15 km, për Qytetin Tiranë, Kashar, Dajt, Qafshatë - 20 km, dhe për qytetin Shijak, Fllakë - 15 km. Ndërsa për sistemet e Alarmit ky operator ekonomik nuk ka paraqitur Autorizim Individual, ashtu siç është kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat standarte të tenderit. Operatori ekonomik “Ilar” shpk ka paraqitur autorizim individual për sisteme Radiokomunikimi për qytetin Korçë -10 km , Pogradec -10 km dhe Tiranë 15 km, për sistemet e Alarmit ky operator ekonomik ka paraqitur Autorizim Individual për qytetin e Pogradecit 10 km dhe qytetin e Tiranës 15 km.

KPP gjykon se, operatorët ekonomik “Vaso Security” sh.p.k dhe “Arb Security” shpk me dokumentacionin e paraqitur nuk e plotësojnë kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi me *Autorizimet Individual për caktim dhe përdorim frekuencave Radiokomunikim dhe RadioAlarm nuk janë për qarkun Korçës por për qytetin e Korçës*, referuar vendit të instalimit, distanca në kilometra e përcaktuar në autorizimet individual përkatëse, nuk përfshin në frekuencë vendodhjen e objekteve që do të kryhet shërbimi në qytetin e Pogradecit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimes “Nazeri 2000” shpk mbi kualifikimin e shoqërisë “Vaso Security” sh.p.k. dhe “Arb Security” shpk., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim pasi, referuar gjykimit mësipër në pikën III.1.8., gjendja faktike dhe juridike e operatorëve ekonomik “Vaso Security” sh.p.k. dhe “Arb Security” sh.p.k, do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimesit.

III.3. Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, rezulton se autoriteti kontraktor në datën 25.08.2017 ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit duke publikuar “Njoftimin e Fituesit” për operatorin ekonomik “Arb Security” sh.p.k. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 9 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në nenin 63 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” Në nenin 63 pika 3 e *lex specialis*, LPP parashikohet se “ Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.” Gjithashtu në nenin 63 pika 6 e *lex specialis* i cili parashikon të drejtën ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik parashikon se “ [...] Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor [...]”.

III.3.1. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor në datën 25.08.2017 ka vepruar në kundërshtim të hapur me ligjin duke shkelur afatet proceduriale të ankimi duke “Njoftuar Fituesin” brënda hapësirës ligjore ku operatorëve ekonomikë ankimesi i lind e drejta e shterimit të ankimit administrativ në një shkallë më të lartë ankimi. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të presë përfundimin e plotë të afateve të ankimit të operatorëve ekonomikë ankimesi pranë Komisionit të Prokurimit Publik në zbatim të nenit 63 pika 3 dhe pika 6 e LPP-së. Referuar parashikimit të mësipërm, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatorët ekonomik ankimesi kanë qenë brenda afateve kohore të ankimit pranë K.P.P si në momentin e Njoftimit të Fituesit të procedurës së prokurimit gjithashtu edhe në momentin e dorëzimit të ankesës pranë KPP.

III.3.2. Bazuar në nenin 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se “3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji,ka të drejtë:a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;d) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese”.

III.3.3. Në nenin 28 pika 2 gërma “d” të VKM, nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet se “[...] Komisioni, pas shqyrtimit administrativ të ankesës vendos me akt të motivuar: b) Të anulojë plotësisht ose pjesërisht vendimin ose veprimin e autoritetit kontraktor të nxjerrë në kundërshtim me ligjin, si dhe të udhëzojë vazhdimin e procedurës së prokurimit në përputhje me ligjin, duke treguar veprimet që duhet të kryhen në vijim; [...]”

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-16022-06-01-2017 me objekt: “Shërbimi i ruajtjes fizike të objekteve të Ujësjellës Kanalizime Sh.a Pogradec për 11 muaj”, me fond limit 15,356,460 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 11.08.2017, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Sh.a Pogradec.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Arb Security” sh.p.k dhe “Vaso Security” sh.p.k, dhe të korigjojë shkeljet duke i skualifikuar këta operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e datës 25.08.2017 në lidhje me Njoftim Fituesin e procedurës objekt ankimi.
4. Autoriteti kontraktor, brënda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Nazeri 2000” sh.p.k.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1426 Protokolli; Datë 31/08/2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha